



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2020:143709 **C. nr. 1559/2020**
Datë: 12.02.2025
Numri i dokumentit: 06841580

GJYKATA THEMELOR NË PRIZREN, gjyqtari Atdhe Berisha, në çështjen kontestimore sipas padisë së paditësve: M.G., S.G., L.G., A.G.1., B.G. dhe A.G.2., të gjithë nga Prizreni, Lagja Dardani, të cilët me autorizim I përfaqëson avokati B.J. nga Prizreni, kundër të paditurës B.K.S. me seli në Prishtinë, për shkak të kompensimit të demit, pas seancës publike të shqyrtimit kryesor, me date 25 Shtator 2024, morri këtë:

A K T G J Y K I M

Detyrohet e paditura B.K.S. me seli në Prishtinë që paditësve:

1. A.G.1. nga Prizreni, në emër të fitimit të humbur për periudhën nga data 01.06.2020 deri me datë 30.06.2024, t'i paguaj shumën 32,422,00 €. Si dhe në emër të rentës mujore të kapitalizuar, nga data 01.07.2024 deri më datë 18.10.2025 t'i paguaj shumën 10.321,50 €.
2. L.G. në emër të fitimit të humbur për periudhën nga data 01.06.2020 deri me datë 30.06.2024, t'i paguaj shumën 32,422,00 €. Si dhe në emër të rentës mujore të kapitalizuar, nga data 01.07.2024 deri më datë 30.10.2029 t'i paguaj shumën 46.768,00 €.

Të gjitha këto me kamat vjetore prej 8 % nga data datë 20.12.2019 e deri në pagesën definitive, nënë kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm

Detyrohet B.K.S. t'i paguan shpenzimet e procedurës për paditësit shumën e përgjithshme 2.640,60 €, 15 ditë nga dita e nxjerrjes së këtij aktgjykimi, nënë kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin AC. nr. 1154/2016 datë 15.11.2019, Gjykata e Apelit në Prishtinë, ka ndryshuar aktgjykimin C. nr. 535/13 datë 22.01.2016, për rentën e arritur edhe në të ardhmen, ashtu që ka detyruar të paditurën B.K.S. që paditësve L.G. dhe A.G.1., në emër të rentës së arritur për pagës për periudhën e kaluar prej datës së aksidentit 28.01.2012 e deri me datë 31.05.2015, tu paguan shumën 45.244,50 €. Ndërsa për periudhën e ardhshme në emër të mbajtjes së humbur për të dy fëmijët nga data 01.06.2015 deri më datë 18.10.2025 shumën 1.350,65 dhe vetëm për të miturën L.G. nga data 18.10.2025 deri më datë 30.03.2029, shumën

mujore nga 675,30 €. Me kamat si për mjetet e deponuara në bankat private të afatizuara mbi një vit pa destinim të caktuar, nga data 22.01.2016 deri në pagesën definitive.

Gjithashtu me akt aktgjykim e ka detyruar të paditurën t'i paguan paditësve shpenzimet e procedurës.

Pasi që aktgjykimi i Gjykatës së Apelit është Bërë i plotfuqishëm, palët ndërgjyqëse, me datë 20.12.2019, kanë arritur ujdj jashtëgjyqësore për ekzekutimin e aktgjykimit të Gjykatës së Apelit Ac. nr. 1154/2016.

Pas paraqitjes së revizionit, Gjykata Supreme e Kosovës, me Aktgjykimin Rev. Nr. 118/2020 datë 06.04.2020, ka pranuar revizionin vetëm sa i përket rentës së gjykuar. Ka prishur aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren dhe Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit në Prishtinë dhe lëndën e ka kthyer në rigjykim.

Pasi që e paditura nuk ka ekzekutuar në tersi ujdinë jashtëgjyqësore dhe atë pas vendosjes me revizion nga Gjykata Supreme, pala paditëse ka ngelur në tersi së në padi dhe kërkesëpadi por tani vetëm duke kërkuar rentën mujore dhe fitimin e humbur për dy fëmijët e mitur.

Në theksimet gjatë seancave thekson që baza juridike nuk kontestohet nga e paditura, ndërsa lidhur me lartësinë e kompensimit sqaron se nga ekspertiza financiare dhe plotësimi i sajë, paraqitet një përlllogaritje reale e kompensimit të fitimit të humbur dhe rentës mujore për të ardhmen deri sa të ekzistojnë kushtet.

I propozon gjykatës që ta miraton kërkesëpadinë e paditësve pasi që ekspertiza e ekspertës ka përfshirë të gjitha faktorët e vlerësimit, ku janë marr parasysh të ardhurat që ka realizuar tani i ndjeri F.G. ku nga atë të ardhura janë hequr shpenzimet e komunalive në vlerën 20%.

I kërkojnë shpenzimet e procedurës në shumën e përgjithshme 2.640,60 € dhe atë për 5 seanca për dy paditësa nga 528,12 € dhe për pagesën e ekspertizës shumën 250,00 €.

E paditur e kundërshton padinë dhe kërkesëpadinë si për nga baza ashtu edhe për nga lartësia. Sqarojnë që me marrëveshjen jashtëgjyqësore, konkretisht në nenin II të sajë e paditura do ta përmbush rentën e ardhshme sipas aktgjykimit, përjashtimisht në rast se ndryshohen rrethanat. E paditura pas arritjes së marrëveshjes ka paraqitur revizion. Pas paraqitjes së revizionit me qëllim të evitimit të përmbarimit të dhunshëm, e njëjta ka arritur marrëveshje, e cila marrëveshje është administruar si provë, në të cilën marrëveshje ne nenin II, ceket se renta në të ardhmen do të përmbushet vetëm në rast se nuk ndryshohen rrethanat. Ashtu që ndryshim të rrethanave ka psi që gjykata Supreme sa i përket rentës dhe fitimit të humbur ka prishur të dy aktgjykimet dhe lëndën e ka kthyer në rigjykim.

Gjithashtu e kundërshtojnë edhe ekspertizën e ekspertës financiare, pavarësisht se ekspertizën e parë e kundërshtojnë lidhur me vlerën 20%, duke arsyetuar se ekspertja nuk është bazuar në ndonjë referencë kur ka nxjerr atë vlerë, pasi që vlera në shtetin Gjerman është më e lartë. Në raportin plotësues nuk paraqesin vërejtje në ekspertizë. Por pasi që kundërshtojnë bazën, ekspertiza nuk është relevante,

Gjykata me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, administroi provat e propozuara nga palët dhe atë: me shikim në ujdinë jashtëgjyqësore të datës 20.12.2020, për ekzekutimin e aktgjykimit dhe me shikim në raportin e ekspertës financiare dhe plotësimin e tij.

Nga Ujdia jashtëgjyqësore për ekzekutimin e aktgjykimit, është vërtetuar që e paditura B.K.S. ka lidhur ujdi jashtëgjyqësore me të paditurit M., M., S., L., A.1., B., dhe A.G.2.

Me këtë ujdi palët ndërgjyqëse janë pajtuar e paditur është pajtuar që vullnetarisht ta ekzekuton aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, ku ndër tjera janë pajtuar që në emër të rentës së arritur për paditësit fëmijët L.G. dhe A.G.1. të kompensohen në shumën 72,935,10 €. Ndërsa janë marr vesh që edhe për rentën e ardhshme të kompensohen sipas atij aktgjykimi.

Nga raporti i ekspertës financiare dhe plotësimin e tij gjykata ka vërtetuar që për shumat e kompensimit për paditësin A.G.1. për mbajtjen e humbur nga data 01.06.2020 e deri më datë 30.06.2024 të jetë nga 661,700 € në muaj, apo në shumën e përgjithshme 32.422,00 €. Ndërsa emër të rentës mujore të kapitalizuar, nga data 01.07.2024 deri më datë 18.10.2025, duke llogaritur nga 661,70 € të kompensohet në shumën e përgjithshme 10.321,50 €.

Nga kjo ekspertizë gjithashtu gjykata ka vërtetuar që për shumat e kompensimit për paditësen L.G. për mbajtjen e humbur nga data 01.06.2020 e deri më datë 30.06.2024 të jetë nga 661,700 € në muaj, apo në shumën e përgjithshme 32.422,00 €. Ndërsa emër të rentës mujore të kapitalizuar, deri më datë 30.10.2025 të kompensohet në shumën e përgjithshme 10.321,50 €.

Palët ndërgjyqëse lidhur me llogaritjet e bëra nga ana e ekspertës nuk kanë pasur vërejtje e gjithashtu nuk kanë kërkuar që ekspertja të jetë prezentë.

Pala e paditur pavarësisht që nuk ka pasur vërejtje sa i përket të gjeturave dhe konstatimit të ekspertës, këtë ekspertizë e ka kundërshtuar nga fakti që në rastin konkretë sqaron se mungon baza juridike.

Nga provat e administruara secilën veç e veç dhe të gjitha së bashku, gjykata vendosi të miraton kërkesëpadinë e paditësve.

Për palët ndërgjyqëse ka qenë kontestuese jo vetëm lartësia por edhe baza e kërkesëpadiës.

Pala e paditur ka kundërshtuar padinë dhe kërkespadoinë nga fakti që ndryshim i rrethanës, ashtu siç është përcaktuar në ujdinë jashtëgjyqësore ka qenë mënyra e vendosjes sipas vendimit të Gjykatës Supreme, pas paraqitjes së revizionit. Mbi këtë bazë edhe sqarohen se e kundërshtojnë padinë dhe kërkesëpadinë për pjesën e mbetur të kërkesës, e cila ka të bëjë me fitimin e humbur dhe rentës së kapitalizuar.

Në kuptim të nenit 178 paragrafi 2 të LMD-së, personin të cilin e ka ushqyer tani i ndjeri F.G. në rastin konkretë të paditurit L.G. dhe A.G.1. si fëmijë të mitur të tani të ndjerit F.G. kanë të drejtë në kompensim në emër të rentës në të holla, pasi që paditësit janë ushqyer ose i ka ndihmuar rregullisht personi që i është shkaktuar vdekja, ashtu që këta paditësa kanë pasur të drejtë të kërkoj ushqim nga tani i ndjeri F.G. i cili në aksidentin e datës 12 Shtator 2012 ka humbur jetën. Ku nga vdekja e tij kanë humbur ushqimit ose ndihmën që to ti siguronte babai i tyre, tani i ndjeri F.G. dhe atë deri sa paditësit të arrinin moshën madhore, konkretisht deri në moshën 18 vjeçe.

Pavarësisht se gjykata Supreme me aktgjykimin e saj, i ka prishur aktgjykimet e Gjykatës së Shkallës së parë dhe aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, ajo nuk ka refuzuar kërkesën sa i përket rentës, por lëndën e ka kthyer në rivendosje vetëm lidhur me këtë kërkesë. Ndërsa për kërkesat tjera të njëjtat i ka vërtetuar.

Duke pasur parasysh këtë Gjykata tani ka gjetuar se vetë aktgjykimi i Gjykatës Supreme ka vendosur bazën ligjore edhe për këtë kërkesë. Me atë aktgjykim është vërtetuar që paditësit L.G. dhe A.G.I. kanë të drejtë në fitimin e humbur dhe rentën në të holla për shkak të humbjes së babai të tyre. Aktgjykimi i Gjykatës Supreme çështjen e ka kthyer në rivendosje vetëm me qëllim të përcaktimit të lartësisë së të hollave që duhet të kompensohen për këtë formë të kompensimit. Ashtu që pretendimi i palës së paditur që në rastin konkretë mungon baza ligjore, për gjykatën është i pabazuar.

Lidhur me lartësinë e kompensimit gjykata i kushtoi besimin e plotë raportit të ekspertës financiare dhe plotësimit të sajë duke vlerësuar që shpenzimet e kalkuluara nga ana e ekspertës që njihen si shpenzimet të komunalive, është i saktë dhe në përputhje me shpenzimet që behën në Shtetin Gjerman. Pavarësisht se në ekspertizën e parë e paditura e kishte kundërshtuar lartësinë me pretendimin se pagesa e komunalive nuk është llogaritur drejt. Mirëpo pas plotësimit të ekspertizës pala e paditur nuk ka pasur vërejtje sa i përket të gjeturave të ekspertës, por ekspertiza është kundërshtuar vetëm mbi bazën e mungesë së bazës juridike.

Pavarësisht se palët ndërgjyqëse kanë lidhur ujdinë jashtë gjyqësore, gjykata lidhur me bazën e kërkesëpadisë ka vlerësuar aktgjykimin e Gjykatës Supreme, i cili ka vërtetuar bazë për atë formë të kompensimit dhe as që ka dashur të lëshohet në përmbajtjen e ujdisë, pavarësisht që për gjykatën edhe për atë lloj të kompensimit palët janë marr vesh.

Gjykata ka llogaritur kamatën vjetore ndëshkuese prej 8 %, pasi kamatën e ka llogaritur pas nxjerrjes së aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës.

Lidhur me shpenzimet gjykata va vendosur në kuptim të nenit 452 lidhur me nenin 463 të LPK-së, pasi që pala e paditur e ka humbur kontestin, ndërsa pala paditëse shpenzimet e procedurës i ka kërkuar në përputhje me tarifën e Odës së Avokatëve, e të cilat shpenzime kjo gjykatë i ka pranuar.

GJYKATA E THMELORE NË PRIZREN
C.nr. 1559/2020 datë 25 Shtator 2024

Gj y q t a r i
Atdhe Berisha

UDHËZIME PËR ANKESË: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur mund të paraqet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi.